

 <b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova Republic of Kosova	<b>DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> Opstina Istog Municipality of Istog
	<b>Nr. 11-351-15/21</b>	<b>Dt. 05.03.2021</b>	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH -së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-7751 të datës 01.03.2021, KEDS sh.a. ELKOS Group Pejë të cilën e përfaqëson Ramiz Kelmendi, për lëshimin e Lejës ndërtimore me karakter të përhershëm për **Zhvendosjen e rrjetit për furnizim me energji elektrike në rr. “Nëna Tereze” në Istog**, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

#### LEJE NDËRTIMI PËR ZHVENDOSJE TË RRJETIT 10(20)/0.4(kV) KEDS sh.a. NË ISTOG

<b>Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:</b>			
Emri:	- Investitorit ELKOS Group Pejë të cilën e përfaqëson Ramiz Kelmendi		
Adresa:	rr. “Nëna Tereze” nr. _____, Istog		
Telefoni:	██████████	Emaili:	

Emri i Projektit:	<b>Ndërtimin e objektit – ZHVENDOSJE TË RRJETIT 10(20)/0.4(kV) NGA KEDS sh.a. NË ISTOG</b>		
Emri i Projektuesve:	1. Fatmir Jashari, inxh për EL		
Co. projektuese:	SH. A. KEDS Prishtinë		
Telefoni:	██████████	Emaili:	

<b>Për punët ndërtimore në vijim:</b>
<b>Adresa:</b> Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale është përmes rrugës ekzistuese “Nëna Tereza” gjegjësisht pjesa e parcelës nr. 01782-2, ZK Istog

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
  - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike;
  - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## Arsyetim

Aplikuesi - investitor në kërkesën me nr. 11-351-7751 të datës 01.03.2021, Kompania ELKOS Group Pejë të cilën e përfaqëson Ramiz Kelmendi ka kërkuar nga DPUM, lëshimin e Lejes ndërtimore për **Ndërtimin e objektit – ZHVENDOSJE TË RRJETIT 10(20)/0.4(kV) KEDS sh.a.** në ISTOG konkretisht përbri rrugës “Nëna Tereze” në parcelën kadastrale nr. 01782-2, ZK Istog, në lokacionin e përshkruar në paragrafin 1. të dispozitivit të vendimit të lejes ndërtimore.

DPUM pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të kërkesës baxë, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 5/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:**

- Dëshmi të pronësisë dhe dokumentacioni personal i fotokopjuar
- Kushtet Ndërtimore (është paisur-fotokopje)
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera – nuk ka

**Shtojcë:** Situacioni i kompleksit me pozicionim të objektit, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me kordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

**Udhëzim juridik:** Pala e pa knaqur me këtë vendim, përmes kësaj drejtorie, me ankesë mund ti drejtihet MMPH në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të do të përcillet te organi epror – MMPH.

**I dorëzohet:** Kërkuarit/Investitorit, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim, Drejtorisë së kadastrit, Drejtorisë së financave, Qendrës për shërbime me qytetar.

### **DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOGUT,**

Udh. Sek. Urbanist,  
ark. Rexhep Blakaj id


